



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 29 nëntor 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Gëzim Kelmendi dhe Liburn Aliu.

Munguan: Sasha Gjokiq dhe Flora Brovina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.11.2011;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 23.11. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 23 nëntor 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre

Fikrim Damka- Deklaroi se i kemi propozuar disa amendamente për këtë Projektligj, të cilat janë në harmoni me qëndrimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Time Kadriaj- Tha se Qeveria na ka sjellë para aktit të kryer. Me këtë Projektligj, po u bëhet një padrejtësi veteranëve. Ne i kemi hartuar amendamentet, duke i shtyrë beneficionet për veteranët deri në vitin 2015, por edhe kjo ka qenë e paparanueshme për FMN-në. Faji për këtë është edhe te MPMS-ja, e cila nuk ka punuar me përkushtim për këtë ligj dhe po ashtu nuk ka punuar për të verifikuar numrin e saktë të veteranëve. Po të dihej numri i veteranëve, tash do ta kishim më lehtë për llogaritjen e kostos së këtij ligji. Kërkesa e vetme e veteranëve ka qenë që të përfshihen në këtë ligj, edhe pse beneficionet për ta do të fillojnë më vonë. Ne do të duhej që si Komision, të takohemi me shoqatat dhe t'u sqarojmë dhe jo të bëhet në takime private.

Salihe Mustafa- Ne si Komision jemi munduar t'i harmonizojmë qëndrimet, por kemi gabuar paksa, sepse nuk e kemi analizuar në fillim se a do të mund të kalojë ligji në këtë mënyrë apo jo. Megjithatë, konsideroj se Shoqatat e dalura nga lufta, do ta kuptojnë pozicionin tonë dhe do të pajtohen me këtë ligj.

Bahri Thaçi- Ne të gjithë jemi këtu për ta mbrojtur interesin e popullit, por ai interes mbrohet më së miri duke e mbrojtur interesin e shtetit. Shteti ynë është financiarisht i paqëndrueshëm dhe duhet të kemi kujdes në veprimet tona. Institucionet financiare kanë qenë të qartë se nuk mund të lejojnë beneficione për cilëndo kategori pa e ditur numrin e saktë të përfituesve eventuale të atyre beneficioneve. Qeveria është zotuar se shumë shpejt do të nxjerrë një ligj të veçantë për veteranët. Duhet të procedojmë dhe ta përmbyllim këtë punë.

Nazane Breca- Deklaroi se për këtë Projektligj kemi punuar shumë. Duhet të jemi të vëmendshëm se çka veprojmë sot, në mënyrë që mos t'i mbajmë peng edhe kategoritë e tjera.

Fikrim Damka- Tha se do t'i procedojmë amendamentet për këtë Projektligj, të cilat janë si vijon:

Amendamenti 1

Në nenin 1, pas UÇK – së, shtohen fjalët „, dhe të gjithë atyre që ranë për kauzën kombëtare”.

Deputeti Salih Asllanaj

Amendamenti 2

Dy propozime

Komisioni Funksional

Në nenin 3, paragrafi 1.6 riformulohet si vijon:

“1.6. **Dëshmor i Kombit** ” është pjesëmarrësi i UÇK-së që:

1.6.1. Ka rënë në luftë për lirinë e vendit nga viti 1997 -1999.

1.6.2. Është plagosur në luftë për lirinë e vendit në periudhën 1997 -1999 dhe ka vdekur nga plagët e marra brenda 3 (tre) viteve.

Deputeti Salih Asllanaj

Në nenin 3, paragrafi 1.6, riformulohet :

“**Dëshmor i Kombit**” është pjesëtari i UÇK-së dhe veprimtari i çështjes kombëtare, i rënë në luftë për lirinë e vendit nga viti 1945 – 1999.

Amendamenti 3

Në nenin 3, paragrafi 1.7 riformulohet :

1.7. “Invalid i luftës së UÇK-së” është pjesëmarrësi i UÇK-së , organizmi i të cilit është dëmtuar mbi 20% për shkak të plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në luftë, apo si i internuar (i burgosur) në burgjet apo kampet e armikut dhe shtetasi i huaj si veteran i UÇK –së, nga 1997- 1999.

Komisioni Funksional

Amendamenti 4

Në nenin 3, paragrafi 1.9, hiqen fjalët „ brenda periudhës 30.12.1991 deri 20.06.1999” dhe zëvendësohet me fjalët „ gjatë periudhës 1997-1999” .

Komisioni Funksional

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafi 1.10 hiqet.

Komisioni Funksional

Amendamenti 6

Në nenin 3, nënparagrafi 1.16 , fjala „prindërit” kalon para fjalës „njerka”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 7

Në nenin 3, pas paragrafit 1.16 , shtohet paragraf i ri si vijon :

“**Familje e Dëshmorit të Kombit** ” është ajo familje e cila i ka dhënë Kosovës, një apo më shumë dëshmorë.

Komisioni Funksional

Amendamenti 8

Në nenin 3, paragrafi 1.18, riformulohet :

„ **ZÇKL**” është Zyra për Çështjet e Kategorive të dala nga Lufta.

Komisioni Funksional

Amendamenti 9

Në nenin 5, nënparagrafi 1.1.5, riformulohet:

1.1.5 Pensionin familjar, familja e ngushtë e realizon për të rënë dhe të zhdukurit në vitet 1997-1999.

Komisioni Funksional

Amendamenti 10

Në nenin 6, paragrafi 1.7, në fund të paragrafit hiqen fjalët „ sëmundja e shkaktuar nga” .

Komisioni Funksional

Amendamenti 11

Në nenin 6, paragrafi 3, nenin 8, paragrafi 1.7, dhe në nenin 9 paragrafi 1.14 , në fund të paragrafit, hiqen fjalët „ në rast të vështirësisë financiare” dhe zëvendësohet me fjalët

„në rast të gjendjes së rëndë ekonomike, kur i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 12

Në nenin 9 paragrafi 1.16, të hiqet .

Komisioni Funksional

Amendamenti 13

Në nenin 10, paragrafi 1.1, riformulohet „ Grupi I - invalidët me 81% deri 100% të dëmtimit trupor”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 14

Në nenin 11, paragrafi 5, pas fjalës „, vdekur ‘’ shtohet fjala „, brenda” .

Komisioni Funksional

Amendamenti 15

Në nenin 13, paragrafi 1.4, në fund të paragrafit hiqen fjalët, „vështirësive financiare’’ dhe zëvendësohet me fjalët „, gjendje të rëndë ekonomike, dhe i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 16

Në nenin 14 , paragrafi 2.1. hiqet „mbi 80%” dhe zëvendësohet me „, 81%-100%”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 17

Në nenin 15, paragrafi 5, pas nënparagrafit 7.9, shtohet një nënparagraf i ri : „Ish- Ministrisë së Mbrojtjes” .

Komisioni Funksional

Amendamenti 18

Në nenin 15, paragrafi 5, pas nënparagrafit 7.9 shtohet një nënparagraf i ri :
“një përfaqësues i Institutit të Historisë së Kosovës” .

Deputeti Salih Asllanaj

Amendamenti 19

Në nenin 16, paragrafi 2, pas fjalës „ Departamentit” shtohet fjala „ të Ministrisë” dhe në fund të paragrafit hiqet fjala „ Ministrisë” dhe zëvendësohet me fjalën „ Luftës” .

Komisioni Funksional

Amendamenti 20

Titulli i nenit 17, riformulohet: „ **Zyra për Çështjet e Kategorive të dala nga Lufta**” dhe të bëhet harmonizimi në tërë nenin .

Komisioni Funksional

Amendamenti 21

Në nenin 20, paragrafi 1.4.3 hiqen fjalët „ të anëtarëve të familjeve të ngushta” dhe zëvendësohet me „ anëtarëve të ngushtë të familjeve”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 22

Titulli i nenit 22 , riformulohet: „ Trajtimi i kërkesave në shqyrtim” .

Komisioni Funksional

Amendamenti 23

Në nenin 23, paragrafi 1, në fund të paragrafit , pas fjalës „ Ligji ” të shtohen fjalët „pas verifikimit nga komisioni qeveritar i paraparë në nenin 15, të këtij Ligji”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 24

Pas nenit 25, shtohet neni i ri si vijon :

Dispozitat kalimtare

“Ata përfitues, që kanë gëzuar beneficione para datës 15 maj 2011, do të vazhdojnë t’i gëzojnë ato beneficione . Nëse gjatë procesit të auditimit bëhet e ditur se disa nga këto beneficione janë përfituar në mënyrë të padrejtë, atëherë këto beneficione do të ndërpriten”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 25

Në tërë Projektligjin të bëhet harmonizimi i teksteve në tri gjuhët.

Komisioni Funksional

Pas diskutimeve, Komisioni nuk i përkrahi amendamentet e propozuara nga deputeti Sali Asllanaj, ndërkaq amendamentet e tjera i miratoi me shumicë të votave.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka